



Human Rights Review Panel

Buletini informativ # 5 – korrik-shtator 2013

- Seanca e 17-të e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut (Paneli)
- Shkelje të tjera të të drejtave të njeriut në lëndët e Vidovdanit
- Takimi me zëvendës shefen e Misionit të EULEX-it
- Fushata informuese

Seanca e PSHDNJ-së

Seanca e 17-të e rregullt e PSHDNJ-së është mbajtur në Prishtinë nga data 28 - 30 gusht 2013. Paneli ka shqyrtuar shtatë ankesa dhe ka marrë vendime rreth gjashtë lëndëve. Në fillim të seancën kanë qenë 30 ankesa të papërfunduara pranë Panelit.

Vendimet e tjera rreth Vidovdanit

PSHDNJ-ja ka shpallur se ka pasur shkelje të të drejtave të njeriut nga EULEX-i Kosovë gjatë kryerjes së mandatit të tij ekzekutiv sa i përket [dy rasteve](#), të cilat kanë ndodhur në *Vidovdan* më 28 qershor 2012. Festimi i *Vidovdanit* shënon një festë të rëndësishme fetare në të cilën qindra serb etnikë vizitojnë vendet përkujtimore në Kosovë.

Ankuesit të cilët ishin pjesëmarrës në këto festime kanë pohuar se ishin ndaluar nga policia e Kosovës në pikën kufitare Merdare. Policia e Kosovës ju kishte konfiskuar gjësendet e tyre, që përfshinin bluzat pa mëngë që mbanin emblema serb dhe flamujt serb, dhe kishin kërcënuar ankuesit.

Paneli ka përcjellë arsyetimin [e vendimeve të veta të fundit](#) lidhur me rastet që kanë dalë nga festimit e Vidovdanit të vitit 2012, duke vënë në dukje detyrimin e EULEX-it sipas [Veprimit të përbashkët të Këshillit](#) për të siguruar se duhet të kryhen aktivitete nga ana e tij në përputhje me standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut. Paneli ka konstatuar se EULEX-i është pritur që të ndërmerr masa të nevojshme dhe efektive, brenda fushëveprimit të kompetencave, burimeve dhe aftësive të tij për të siguruar mbrojtjen efektive të të drejtave të njeriut të personave në territorin e Kosovës. Paneli ka konstatuar se EULEX-i kishte caktuar burime të pamjaftueshme për të siguruar respektimin e të drejtave të njeriut nga autoritetet e Kosovës dhe të palëve të treta gjatë operacionit të sigurisë së Vidovdanit. Më tej, Paneli ka deklaruar se EULEX-i kishte ofruar trajnim jo të duhur dhe udhëzime të pamjaftueshme operacionale stafit të tij, të cilët ishin dislokuar në atë ditë.

Prandaj ankuesit nuk kanë mundur të gëzojnë të drejtat e tyre të respektimit të jetës private, të drejtat e tyre për liri të tubimit si dhe të drejtat e tyre për ushtrimin e fesë së tyre. Paneli po ashtu ka rekomanduar që të zbatohen një sërë masash korrigjuese nga shefi i Misionit në mënyrë që të trajtohen çështjet në fjalë.

Vendimet

Paneli ka shpallur tre lëndë të tjera të papranueshme. Dy prej tyre ([2013-16 Almir Susaj](#) dhe [2013-02 Arsim Krasniqi](#)) kishin të bëjnë me keqtrajtimin e dyshuar nëpër burgje, përderisa [lënda e tretë](#) kishte të bëjë me pretendimin për paraburgim të jashtëligjshëm. Paneli ka gjetur në të gjitha këto tre lëndë se ankesat nuk kanë hyrë brenda kuadrit të mandatit të vet. Ai përkujton se mandati i Panelit mbulon vetëm ankesat që lidhen me shkeljet e të drejtave të njeriut nga ana e EULEX-it gjatë ushtrimit të mandatit të tij ekzekutiv në sektorët e gjyqësisë, policisë dhe doganave.

Vendimet e Panelit do t'ju dërgohen parashtruesve të ankesave si dhe shefit të Misionit të EULEX-it. Këto vendime do të publikohen në kohën e duhur në faqen e internetit të Panelit pasi të përkthehen në gjuhën shqipe dhe serbe. Seanca e ardhshme e Panelit është caktuar të mbahet nga 11-14 nëntor 2013, në Prishtinë.



Paneli gjatë seancës në sallën e takimeve në PSHDNj - nga e majta në të djathtë: John J Ryan, Magda Mierzewska, (Kryesuese e PSHDNj-së), Joanna Marszalik, Florian Razesberger, Guénaél Mettraux dhe Katja Dominik (PSHDNJ)

Takimi me zëvendës shefen e EULEX-it dhe shefin e zyrës për të drejta të njeriut dhe çështje ligjore



Joëlle Vachter – ZShM të EULEX-it dhe Magda Mierzewska
Kryesuese e PSHDNj-së në takim

Më 29 gusht, PSHDNj-ja është takuar me zëvendës shefen e Misionit të EULEX-it, Joëlle Vachter-in dhe shefin e zyrës për të drejta të njeriut dhe çështje ligjore, Helppikangas Jarmo-n. Çështjet që janë diskutuar kanë qenë ristrukturimi i EULEX-it Kosovë dhe ndikimi i tij i mundshëm në mandatin ekzekutiv të EULEX-it pas qershorit të vitit 2014, fushata informuese në vazhdim e PSHDNj-së, si dhe çështje të tjera me interes të ndërsjellët.

PShDNj-ja ka përpunuar një tabelë të jurisprudencës, duke i theksuar shumë çështje që lidhen me juridiksionin e vet, çështjet procedurale si dhe lidhur me meritat e ankesave. Tabelën mund ta shihni përmes faqes së internetit të Panelin në <http://www.hrrp.eu/jurisprudence.php>


Fushata informuese

Sekretariati ka vazhduar me fushatën e vet duke mbajtur takime në Graçanicë, Prizren dhe Mitrovicë gjatë së cilave Sekretariati i PShDNj-së ka takuar dhe i ka njoftuar lidhur me punën, operacionet dhe procedurat homologët e vet të OJQ-ve për të drejta të njeriut, zyrtarë publik/institucional, përfaqësues fetarë dhe organizata ndërkombëtare, si p.sh OSBE-në. Për më tej, Sekretariati po ashtu ka vazhduar me fushatën e vet informuese në Prishtinë, ku është takuar në mes të tjerash me përfaqësuesit e Qendrës për Ndihmë Ligjore dhe Zhvillim Rajonal (QNLZHR).

Statistika e lëndëve në PSHDNj

Pavarësisht prej njohurisë së kufizuar në mesin e popullatës lidhur me ekzistencën e Panelit, dhe pavarësisht se ka pasur vetëm burime modeste gjatë komunikimit me publikun e gjerë, Paneli ka vërejtur një rritje të vazhdueshme të numrit të lëndëve gjatë vitit 2013.

Që nga janari i vitit 2013, janë regjistruar gjithsej 22 lëndë të reja në Panel. Gjatë periudhës së njëjtë të vitit 2012 vitit vetëm 13 lëndë ishin regjistruar. Kjo përbën një rritje prej 70% në paraqitjen e lëndëve të reja për periudhën në fjalë. Paneli vazhdon me përpjekjet e veta për të informuar popullsinë e gjerë lidhur me mandatin, procedurat dhe operimet e veta.



PARASHTRIMI I ANKESAVE

(Rregullat 25 dhe 26 të Rregullores së punës të PShDNj-së)

Kush?

Çdo person i cili nuk punon për misionin e EULEX-it në Kosovë, dhe i cili ankohet se ka qenë viktimë e shkeljes së të drejtave të njeriut nga ana e misionit të EULEX-it në Kosovë gjatë zbatimit të mandatit ekzekutiv të tij. Ankuesi (personi që e bën ankesën) mund të përfaqësohet nga ndonjë avokat ose përfaqësues tjetër sipas dëshirës së tij ose saj. Në këtë rast duhet të plotësohet autorizimi.

Çka?

Paneli do t'i shqyrtojë vetëm ato ankesa që kanë të bëjnë me këto shkelje të pohuara e të cilat kanë ndodhur në Kosovë pas datës 9 dhjetor 2008. Shkelja duhet të jetë shkaktuar nga misioni i EULEX-it në Kosovë gjatë zbatimit të mandatit ekzekutiv të tij.

Paneli nuk do t'i shqyrtojë procedurat gjyqësore të kryera nga gjykatat në Kosovë.

Kur?

Ankesa duhet t'i parashtrohet Panelit para datës 9 shtator 2010 ose brenda gjashtë muajve nga data e shkeljes së pohuar.

Si?

Ankesa duhet të paraqitet me shkrim. Ankesa nuk mund të bëhet me telefon. Ankuesi mund ta përdorë gjuhën angleze, shqipe ose serbe.

Normalisht, ankesa duhet të bëhet në formularin përkatës dhe të shoqërohet me dokumente dhe vendime përkatëse (nëse ka), sipas udhëzimeve në formular.

Nëse ankesa paraqitet me anë të letrës, në të duhet të përcaktohet, të paktën në formë të përmbledhur, lënda e ankesës në mënyrë që ajo të shqyrtohet më tej.

Ku?

Ankesa mund të parashtrohet në

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut - Sekretariati
Rruga: Rrustem Statovci nr. 29 – 10000 Prishtinë – Kosovë
Tel: +381 (0) 38 78 2125
Ankesa gjithashtu mund të parashtrohet përmes postës elektronike në: office@hrrp.eu
www.hrrp.eu

Plotësimi i formularit për ankesë

Ankesa duhet të shkruhet qartë dhe lexueshëm, dhe mundësisht të jetë e shtypur me kompjuter.

Formulari duhet t'i përfshijë të gjitha hollësitë e nevojshme për ta kontaktuar ankuesin, nëse ka nevojë.

Nëse ankesa përmban fakte të dokumentuara, duhet të paraqiten kopjet e lexueshme. **Mos i dërgoni dokumentet origjinale.**

Dokumentet duhet të renditen sipas datës dhe të shënohen me numra rendor të njëpasnjëshëm, si dhe të jepet një përshkrim i shkurtër (p.sh. letër, urdhër, vendim, ankesë, etj.).

Ankesës i caktohet numri i dosjes. Numri i dosjes duhet të përmendet në të gjitha korrespondencat vijuese. Nëse ankuesi tashmë e ka një ankesë, e cila është duke u shqyrtuar nga Paneli, ai ose ajo duhet ta informojë Panelin lidhur me numrin e dosjes së mëparshme. Nëse ankuesi për arsye të ndryshme nuk dëshiron që identiteti i tij ose saj të bëhet publik, ai ose ajo duhet ta plotësojë pjesën përkatëse në formularin e ankesës.